



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS
OSNOVNI SUD U MITROVICU - BASIC COURT OF MITROVICA

C.nr.408/2015

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i përgjithshëm,
Divizioni Civil, Gjyqtari Naim Meholl, në qështjen juridike kontestimore të
padiçësit nga Mitrovica, të cilin e përfaqëson me autorizim avokati
nga Mitrovica, kundër të paditurës
me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson me autorizim
lidhur me kompensimin e dëmit jo material nga autopërgjegjësia solidare,
përfundimit të seancës kryesore, me datën **14.09.2016**, mori këtë:

AKT GJYKIM

I. REFUZOHET padia dhe kërkesëpadia e padiçësit lidhur me
kompensimin e dëmit jo material nga autopërgjegjësia solidare, kundër të
padiçësit Kompania e Sigurimeve, si e pa bazuar.

II. OBLIGOHET padiçësi që në emër të shpenzimeve të gjykatës për përfundim të
vendimit t'ia paguajë gjykatës shumën prej 15 euro në afat 15 ditor pas
plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit të
detyrueshëm.

Arsyetim

Padiçësi pranë kësaj gjykate si në padin dhe kërkesëpadinë e ushtruar përmes të
autorizuarit të tij dhe të precizuar gjatë shqyrtimit gjyqësor, ka kërkuar që të
njëjtën, ta miratoj në tërësi si të bazuar, për shkak të lëndimeve trupore të cilat i
ka pësuar në aksidentin e datës 08/12/2013, ashtu që ka kërkuar që e paditura
të detyrohet t'ia kompensoj padiçësit shuma si vijon: për dhimbje fizike të
intenzitetit të rëndë e cila ka zgjatur për 60 minuta shumën prej 200 euro, për
dhimbje fizike të intenzitetit të mesëm në kohëzgjatje prej 7 ditësh shumën prej
200 euro, për dhimbjet fizike të intenzitetit të lehtë në kohëzgjatje prej 30 ditësh
shumën prej 200 euro, për gjysmën e shpenzimeve të shërimit, për barna dhe
terapi gjer më tani dhe në të ardhmen shumën prej 208 euro, për ushqimin e
përforcuar shumën prej 200 euro, për frikën primare të intenzitetit posaqërisht të

rëndë i cili ka zgjatur për 20 minutave shumë prej 200 euro, për frikën sekondare të intenzitetit të lartë e cila ka zgjatur 20 minuta shumë prej 200 euro, për frikën sekondare të intenzitetit të mesëm e cila ka zgjatur 10 ditë shumë prej 200 euro, për frikën sekondare të intenzitetit të ultë e cila ka zgjatur 6 muaj shumë prej 200 euro, apo shumë e përgjithshme prej 1808,00 euro. Po ashtu ka kërkuar shpenzimet e procedurës civile dhe atë: në emër të përpilimit të padisë shumë prej 104 euro, në emër të taksës për padi shumë prej 15 euro, si dhe në emër të përfaqësimit për dy seanca nga avokati shumë prej 270 euro, apo totali i përgjithshëm prej 389.00 euro.

Përfaqësuesi i të paditurës gjatë seancës për shqyrtim kryesor, ka deklaruar se e kundërshton për nga baza juridike padin e paraqitur nga paditësi, me arsyetimin se nga provat të cila ndodhen në shkresat e lëndës vërtetohet se paditësi e ka realizuar në tërësi dëmin të cilin e ka pësuar me rastin e aksidentit të datës 08/12/2013, kjo vërtetohet nga procedura kontestimore e zhvilluar pran Gjykatës Themelore Mitrovicë, C.nr.326/2014, përkatësisht procesverbali i seancës gjyqësore i datës 17/06/2015, si dhe vendimi i komisionit të shkallës së parë për trajtimin e dëmeve pran Kompanisë së Sigurimeve * , datë 13/03/2014, nga të cilat prova shihet se atëherë e paditura Kompania e Sigurimeve , e ka pranuar në tërësi përgjegjësin mbi dëmin që iu është shkaktuar paditësit dhe si rrjedhojë e kësaj paditësi e ka kompensuar në tërësi për të gjitha llojet e dëmeve, andaj në mbështetje të dispozitave të LMD-së, del se paditësi është kompensuar në tërësi për dëmin e pësuar nga Kompania e Sigurimeve , dhe në rast të ekzistimit të ndarjes së përgjegjësisë sipas dispozitave të LMD-së, kompania në fjalë mund të kërkojë të drejtën e regresit nga e paditura, andaj, në prani të këtyre rrethanave konsiderojmë se kërkesëpadia e kësaj padie është çështje e gjykuar dhe si të tillë i propozojmë gjykatës që ta refuzon si të pa bazuar.

Gjykata, për vërtetimin e drejtë dhe të plot të gjendjes faktike në procedurën e provave me pëlqimin e palëve i ka lexuar: Ekspertizën e komunikacionit e datës 21/05/2015, procesverbalin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë i datës 17/06/2015, raportin e policisë i datës 08/12/2013 së bashku me skicën nga vendi i ngjarjes, si dhe vendimin e komisionit të shkallës së parë për trajtimin e dëmeve i datës 13/03/2014.

Pasi që Gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, e mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, arriti në përfundimin se në këtë çështje juridike civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Për gjykatën nuk ishte kontestues fakti se me datën 08/12/2013, rreth orës 08:05 minuta, në Mitrovicë, ka ndodhur aksidenti i komunikacionit, ashtu që deri sa drejtuesi i automjetit të markës "VW" tip "Passat", i ishte duke e drejtuar automjetin e tij si pasojë e mos respektimit të dispozitave ligjore mbi komunikacionin rrugor, e ka ndaluar automjetin e tij më afër se 5 metra nga skaji i udhëkryqit, ku nuk ka qenë e lejuar ndalja dhe hapja e dyerëve të



automjetit, në këtë mënyrë automjeti i markës "VW", tip "Kombi, të cilin e drejtonte _____, i cili ishte duke e tejkaluar automjetin e lartëcekur, e godet paditësin _____, i cili në ato momente kishte qenë duke hyrë në derën e majtë të automjetit të markës "VW" tip "Passat", me ç'rast paditësit i shkaktonte lëndime të lehta trupore.

Gjykata duke u bazuar në mendimin dhe konstatimin e ekspertit të komunikacionit ing. _____ e datës 21/05/2015, vërtetoi se deri të aksidenti ka ardhur si pasojë e lëshimeve primare të automjetit të markës "VW", Kombi, të cilin e drejtonte _____, i cili gjatë lëvizjes me automjetin e tij, në Mitrovicë, në rrugën " _____ " në drejtim të stacionit të Autobusëve, nuk ia ka përshtatur shpejtësinë e lëvizjes së distancën, kushteve dhe rrethanave në rrugë, ashtu që si pasojë e këtyre lëshimeve e godet nga mprapa automjetin e markës "VW" Passat, të cilin e drejtonte _____, i cili në ato momente ishte ndalur menjëherë para udhëkryqit në skajin e rrugës në anën e djathtë, edhe pse një ndalje e tillë nuk ishte e lejuar dhe si rrjedhojë e kësaj, në aksidentin në fjalë drejtuesi i automjetit "VW" Passat, ka bërë lëshime të natyrës sekondare në aksidentin e shkaktuar.

Gjykata vendosi sikurse në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimit duke e refuzuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, edhe përkundër asaj se në bazë të ekspertizës së ekspertit të komunikacionit _____, është bërë ndarja e përgjegjësisë në mes të automjeteve "VW" Kombi dhe "VW" Passat, të cilët kanë kontribuar në shkaktimin e aksidentit të datës 08/12/2013, sepse në procedurën kontestimore të zhvilluar pranë kësaj gjykate sipas numrit C.nr.326/2014, e cila procedurë ka përfunduar me pajtim gjyqësor, del se paditësi është kompenzuar në tërësi për të gjitha llojet e dëmeve të cilat i ka pësuar në këtë aksident përkatësisht në vlerën prej 1,500.00 euro, nga e paditura Kompania e Sigurimeve " _____ "

Nga proceverbali i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, C.nr.326/2014, datë 17/06/2015, gjykata vërtetoi se atëherë e paditura Kompania e Sigurimeve " _____ ", përmes përfaqësuesit të saj nuk e ka kundërshtuar bazën juridike të padisë së paditësit por vetëm lartësinë e kërkesëpadisë, ashtu që gjykata erdhi në përfundim se e paditura në fjalë e ka pranuar 100% përgjegjësinë për dëmin e shkaktuar paditësit edhe përkundër ekzistimit të ekspertizës së ekspertit të komunikacionit, me të cilën është bërë ndarja e përgjegjësisë, gjendje kjo e cila vërtetohet edhe nga vendimi i komisionit të shkallës së parë për trajtimin e dëmeve, i lëshuar atëherë nga paditura Kompania e Sigurimeve " _____ " i datës 13/04/2014, nga i cili vendim shihet se kompania në fjalë e ka pranuar 100% dëmin e shkaktuar ndaj paditësit.

Prandaj, gjykata në prani të këtyre rrethanave ka ardhur në përfundim se padia dhe kërkesëpadia e paditësit duhet të refuzohet si e pa bazuar, pasi që paditësi është kompenzuar njëherë për dëmin të cilin e ka pësuar në aksidentin e komunikacionit të datës 08/12/2013, gjendje kjo e cila vërtetohet nga pajtimi gjyqësor i Gjykatës Themelore Mitrovicë, C.nr.326/2014, datë 17/06/2015, arritur në mes paditësit dhe atëherë të paditurës Kompania e Sigurimeve " _____ "

”, ku kjo e fundit ka bërë kompensimin në shumën prej 1,500.00 euro për të gjitha llojet dhe format e dëmeve të cilat i ka pësuar paditësi, kurse pretendimi i paditësit ndaj tani të paditurës Kompania e Sigurimeve ‘ , për kompensim të sërishëm, paraqet kërkesë të dyfishitë për kompensim, dhe një pretendim të tillë gjykata, nuk mundi ta pranoj, sepse në kuptim të dispozitave të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve përkatësisht nenit 169, nuk është i lejuar, sepse njëherë është rivendosur gjendja e mëparshme para-se të jetë shkaktuar dëmi dhe një rivendosje e sërishme e gjendjes së mëparshme, do të paraqiste pasurim pa bazë juridike, andaj, gjykata pas vlerësimit të këtyre rrethanave në raport me provat të cilat ndodhën në shkresat e lëndës, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u bazua në nenin 450 të LPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në bazë të nenit 143 par.1 të LPK-së lidhur me nenin 169 të LMD-së.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i përgjithshëm Divizioni Civil
C.nr.408/15 e datës 14.09.2016



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta e ankesës në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit. Ankesa drejtohet Gjykatës së Apelit e Kosovës në Prishtinë, nëpërmes kësaj Gjykate në kopje të mjaftueshme.

REPUBLIKA E KOSOVES  REPUBLIKA KOSOVA

VENDIMI ËSHTË I PLOTËFUQISHËM
ODLUKA JË PRAVNOSNAZNA
GJYKATA THEMELORË / OSNOVNI SUD
MITROVICË / MITROVICA

Më
Dana

10.10.2016

The image shows a circular official stamp of the Mitrovica Basic Court, identical to the one above. It contains the text "REPUBLIKA E KOSOVES" and "MITROVICË". Overlaid on the stamp is a handwritten signature in black ink, which appears to be "Naim Meholl".